

VENDIM
Nr.88, datë 9.2.2022

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RIKONSTRUKSIONIT TË TRI OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKINË KURBIN DHE
CAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të3 (tri) objekteve arsimore në Bashkinë Kurbin, në masën 223 943 966 (dyqind e njëzet e tre milionë e nëntëqind e dyzet e tre mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) 77 546 181 (shtatëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e dyzet e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) lekë për rikonstruksionin e gjimnazit “At’Shtjefen Kurti”;

b) 53 382 817 (pesëdhjetë e tre milionë e treqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë për rikonstruksionin e Kopshtit nr.3, Laç;

c) 93 014 968 (nëntëdhjetë e tre milionë e katërmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë për rikonstruksionin shkollës 9-vjeçare “Nike Tom Prela”.

2. Bashkisë Kurbin, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 44 788 793 (dyzet e katër milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, që do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) 15 509 236 (pesëmbëdhjetë milionë e pesëqind e nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) lekë për rikonstruksionin e gjimnazit “At’Shtjefen “Kurti”;

b) 10 676 563 (dhjetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë për rikonstruksionin e Kopshtit nr.3 Laç;

c) 18 602 993 (tetëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë për rikonstruksionin shkollës 9-vjeçare “Nike Tom Prela”.

3. Caktimin e Bashkisë Kurbin, si njësi zbatuese për zbatimin e pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama